



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBER  
DREJTORIA EKONOMIKE  
Sektori i Financës

PROJEKT - V E N D I M

Nr. \_\_\_ Date 27/04/2021

“Për përdorimin e fondit Rezerve, nga Granti dhe të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021:

Kërkojmë:

- I. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t’i jepet ndihmë financiare për Shoqatën Kulturorë “Oda Dibrane” si më poshtë:  
1- Për festivalin Mbarëkombëtar “Oda Dibrane” 2021 edicioni që do të zhvillohet në muajin Gusht , në qytetin e Peshkopisë, ku do të marrin pjesë grupe nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva ta mbështesë në vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lekë.
- I. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën 1810 në vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lekë dhe shtohet struktura 1110 llogaria 604 ne vleren 500.000 (pesëqindmijë) lekë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.


PËR BASHKINË DIBËR:

P/Sektorit Juridik  
Elona LUSHA

Drejtor Ekonomik  
Lorenc CIBAKU

P/Sektorit Financës  
Mensur Shehu

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË  
Shkëlqim MURRJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 43 Datë 11.10.2021

**“Për përdorimin e fondit Rezerve, nga Granti dhe të Ardhurat”**


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021: Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 11.10.2021 miratoi me 16 vota pro 0 kunder 0 apstenim.


**VENDIM:**

1. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t’i jepet shpërblim financiar për Shoqatën Kulturore “Oda Dibrane” si më poshtë: Për festivalin Mbarëkombëtar “Oda Dibrane” 2021, në qytetin e Peshkopisë, ku do të marrin pjesë grupe nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva ta mbështesë në vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lekë.
2. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vleren 500.000 (pesëqindmijë) lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Ekonomike Sektori i finances.
5. U shpall sot me datë **11.10.2021**

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.973/3 .prot.

Peshkopi, më 25.10.2021

Lënda : Per vendimin nr. 43, datë 11.10.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.43, date 11.10.2021 “Për përdorimin e fondit Rezervë nga Granti dhe të Ardhurat, për dhenien e një shperblimi financiar për Shoqatën Kulturore “Oda Dibrane”, pas plotesimit të dokumentacionit,

Prefekti konstaton se akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi për dhënie ndihme financiare subjekteve apo personave të përcaktuar individualisht, bën pjese në kategorinë e akteve të karakterit individual, për pasojë miraton në parim një vendimmarrje të tillë që për të gjitha efektet e ligjit është përgjegjësi direkte administrativo- ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-vendime të kësaj natyre në kushtet e zbatimit me korrektesi legjislacionin aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to .

